

Treguesit demografikë


Tremujori III – 2021

Tiranë, më 11 Nëntor 2021: Numri i lindjeve për tremujorin e tretë 2021 është 7.404, duke shënuar një rënie me 7,5 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Numri i vdekjeve për tremujorin e tretë 2021 rezulton 6.037, duke shënuar një rënie prej 8,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Shtesa natyrore e popullsisë (diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve) në tremujorin e tretë 2021, është pozitive me 1.367.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë




**Të dhëna paraprake

Për publikim: 11 nëntor 2021

Në tremujorin e tretë 2021 gjashtë qarqe të vendit shënuan shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në gjashtë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e tretë 2021 vlera më e lartë e shtesës natyrore regjistrohet në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.085 numrin e vdekjeve, ndërsa ai më i vogël regjistrohet në qarkun e Vlorës, ku vdekjet tejkalojnë me 152 numrin e lindjeve.

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarkut, T3 – 2021**



**Të dhëna paraprake

Lindjet

Në tremujorin e tretë 2021 vetëm një qark i vendit ka shënuar rritje të numrit të lindjeve, ndërsa në njëmbëdhjetë të tjerat numri i lindjeve është ulur, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në tremujorin e tretë 2021 numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 2.521 lindje, ndërsa ai më i vogël në qarkun e Gjirokastrës, me 114 lindje.

Rritjen e vetme në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të tretë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Kukësit me 2,2 %.

Uljen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të tretë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Gjirokastrës me – 24,0 %.

Tab. 1: Lindjet sipas qarkut

Nr.	Qarku	III - 20	IV - 20	**I - 21	**II - 21	**III - 21
	Shqipëria	8.007	7.011	6.006	5.993	7.404
1	Berat	292	249	262	216	263
2	Dibër	451	389	360	365	392
3	Durrës	872	781	636	638	870
4	Elbasan	739	709	560	511	661
5	Fier	721	689	526	528	669
6	Gjirokastër	150	125	113	92	114
7	Korçë	482	369	357	380	456
8	Kukës	268	267	178	204	274
9	Lezhë	370	299	295	283	353
10	Shkodër	512	483	432	479	495
11	Tiranë	2.751	2.307	2.020	1.999	2.521
12	Vlorë	368	323	254	280	326
	<i>*Të panjohur</i>	31	21	13	18	10

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja mungon.¹

**Të dhëna paraprake

Vdekjet

Në tremujorin e tretë 2021 nëntë qarqe të vendit kanë shënuar ulje, ndërsa tre qarqet e tjera kanë shënuar rritje të numrit të vdekjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në tremujorin e tretë 2021 numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 108 vdekje, ndërsa ai më i madh në qarkun e Tiranës, me 1.436 vdekje.

Uljen më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të tretë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Dibrës me – 30,6 %.

Rritjen më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të tretë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Vlorës me 15,5 %.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Tab. 2: Vdekjet sipas qarkut

Nr.	Qarku	III - 20	IV - 20	**I - 21	**II - 21	**III - 21
	Shqipëria	6.624	9.397	9.657	5.777	6.037
1	Berat	305	500	529	322	318
2	Dibër	281	307	370	206	195
3	Durrës	618	918	925	492	558
4	Elbasan	632	923	929	566	537
5	Fier	695	1.147	1.165	666	706
6	Gjirokastrë	212	297	281	219	208
7	Korçë	597	837	708	585	564
8	Kukës	153	199	168	125	108
9	Lezhë	326	423	433	231	307
10	Shkodër	618	781	637	499	614
11	Tiranë	1.764	2.504	2.701	1.409	1.436
12	Vlorë	414	558	805	453	478
	<i>*Të panjohur</i>	9	3	6	4	8

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar vdekja mungon.

**Të dhëna paraprake

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).